

D.A.B.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

**RREGULLORE  
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR  
MBROJTJEN NGA HAKMARRJA NË MEPJ**

*Tiranë, Dhjetor 2017*

---

**1** MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

---

KREU I  
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1**  
**Baza ligjore**

Rregullorja për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në MEPJ, bazohet në ligjin nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ILDKPKI.

**Neni 2**  
**Objekti**

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, në zbatim të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoritet publik" ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.
2. "Hakmarrje" është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim, i kryer nga organizata, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.
3. "I sinjalizuar" janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligjit nr. 60/2016, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
4. "ILDKPKI" është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

5. "Mbrojtje" është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të ligjit nr. 60/2016.
6. "Njësia përgjegjëse" shkurt "NJP" është organi i posaçëm, i caktuar brenda MEPJ, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.
7. "Organizatë" është autoriteti publik ose subjekti privat.
8. "Subjekt i vartësisë" është institucioni në varësi të MEPJ-së.
9. "Sinjalizim" është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik.
10. "Sinjalizues" është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
11. "Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni" është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

## KREU II VEPRIMET PROCEDURALE

### **Neni 4 Kryerja e veprimeve procedurale**

1. Veprimet procedurale të NJP në MEPJ kryhen në përputhje me ligjin nr.60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat NJP në MEPJ cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

### **Neni 5 Mbrojtja kundër hakmarrjes**

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas ligjit nr.60/2016, mbrohet ndaj çdo masë hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organizata, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
  - a. shkarkimin nga puna;
  - b. pezullimin nga puna, ose të një, ose më shumë detyrave;
  - c. transferimin brenda ose jashtë organizatës;
  - d. uljen në detyrë;
  - e. uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
  - f. humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
  - g. mosngritjen në detyrë;
  - h. heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
  - i. vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
  - j. forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.
2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.
3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të organizatës, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, paraqet kërkesë me shkrim tek titullari i Ministrisë. Strukturat drejtuese në MEPJ, bazuar në ligjin nr.23/2015 "Për shërbimin e Jashtëm" dhe Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm miratuar me VKM nr.816, datë 07.10.2015, marrin masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë.
4. Në rast të mos miratimit apo moskthimit të përgjigjes në lidhje me kërkesën e bërë personi i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës kompetente.

### KREU III HETIMI ADMINISTRATIV

#### Neni 6

#### **Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje dhe barra e provës**

1. Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, fillimisht duhet të paraqesë kërkesë për mbrojtje tek njësia përgjegjëse e MEPJ-së.
2. Njësia përgjegjëse brenda 5 ditëve të marrjes së kërkesës për mbrojtje njofton sinjalizuesin për rregjistrimin e pretendimit në rregjistrin përkatës.

3. Njësia përgjegjëse heton pretendimet për hakmarrje për të përcaktuar nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur, është duke ndodhur apo pritet të ndodhë akt hakmarrjeje.
4. Subjekti i vartësisë ose struktura përkatëse duhet të provojë që masat e marra në dëm të sinjalizuesit janë bazuar në shkaqe të ndryshme që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sinjalizimin.
5. NJP në MEPJ njofton me shkrim sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për statusin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje dhe për çdo veprim proçedural të ndërmarrë. Pavarësisht nga afatet e njoftimit parashikuar në këtë nen NJP në MEPJ është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion me shkrim paraqitur në çdo kohë nga sinjalizuesi në lidhje me kërkesën e tij.
6. Proçedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.
7. Në rast se në përfundim të hetimit administrativ vërtetohet se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga subjekti i vartësisë apo struktura përkatëse në MEPJ, Njësia përgjegjëse njofton titullarin e Ministrisë dhe merren masa për riparimin e shkeljes sipas legjislacionit në fuqi.
8. Në rast të mos vënies në vend të së drejtës dhe riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes personi i interesuar ose MEPJ ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

## **Neni 7**

### **Bashkëpunimi**

1. Subjekti i vartësisë apo struktura përkatëse dhe sinjalizuesi bashkëpunon me NJP në MEPJ në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes së aktit të hakmarrjes ndaj sinjalizuesit. Ato janë të detyruar të paraqesin informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara NJP në MEPJ.
2. Subjekti i vartësisë apo struktura përkatëse çdo deklaram apo argument të saj e paraqet me shkrim.

## **Neni 8**

### **Mjetet e kërkimit të provës**

1. Gjatë hetimit administrativ NJP në MEPJ, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen mund:
  - a. të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë;
  - b. të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
  - c. të vizitojë vende të caktuara.
2. Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes së aktit të hakmarrjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, NJP në MEPJ kryesisht apo me kërkesën e sinjalizuesit, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).
3. NJP në MEPJ, që zhvillon procedurën administrative mund të vendosë sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative kur gjykon se ekziston mundësia e zhdukjes apo dëmtimit të të saj. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi NJP në MEPJ.

## **Neni 9**

### **Njoftimi i sinjalizuesit**

1. NJP në MEPJ njofton me shkrim sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për statusin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë.
2. Pavarësisht nga afatet e njoftimit, NJP në MEPJ është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion me shkrim, paraqitur në çdo kohë nga sinjalizuesi në lidhje me kërkesën e tij.

## KREU IV

### AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT

## **Neni 10**

### **Masat në përfundim të hetimit administrativ**

1. Nëse në përfundim të hetimit rezulton së është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit, Titullari i MEPJ urdhëron subjektin e vartësisë ose strukturën përkatëse të marrë të gjitha masat për riparimin e shkeljes së kryer. Titullari i Ministrisë parashikon në shkresë edhe masën konkrete që duhet të merret.
2. Nëse subjekti i vartësisë nuk merr masat e kërkuara nga MEPJ, kjo e fundit merr masa sipas akteve ligjore që rregullojnë shërbimin e jashtëm, deri në paraqitjen e kërkesëpadisë në gjykatën kompetente.

### **Neni 11**

#### **Afati i përfundimit të hetimit administrativ**

Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.